



Federata Aeronautike e Kosovës

Meqë Kampionati Kombëtar organizuar nga Federata Aeronautike e Kosovës në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Aeronautikës nuk po njihet si kampionat shtetëror nga Komiteti Olimpik i Kosovës, bordi i FAK vendos të organizojë Ligën Ekipore Shtetërore të Kosovës. Organizimi, rregullat dhe garimi në këtë ligë bazohet në këtë rregullore.

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") me datën 04.03.2019 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 01/2019

ORGANIZIMI I LIGËS EKIPORE TË KOSOVËS NË PARAGLLAJDIZËM

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Të gjitha garat që organizohen në kuadër të ligës ekipore janë gara shtetërore të Kosovës andaj nuk regjistrohen si gara ndërkombëtare FAI CLASS2. Çdo garë e ligës ekipore është përgjegjesi e FAK dhe të drejtën për delegimin e plotë ose të pjesshëm, ose edhe për mosdelegim fare të organizimit të garës e mbanë vetëm bordi i FAK.
- 1.2 Të gjitha garat në kuadër të ligës ekipore janë gara një (1) ditore.
- 1.3 Kalendar i garave për sezonin aktual garues duhet të këtë të paktën katër (4) gara, mirëpo në rast se ka më shumë interesim nga anëtarët e FAK për të organizuar gara, atëhere numri i garave në kuadër të ligës ekipore me vendim të bordit mund të rritet.
- 1.4 Të gjitha klubet me status aktiv në FAK mund të organizojnë gara në kuadër të Ligës Ekipore të Kosovës. Klubet që dëshirojnë të organizojnë garë në kuadër të kësaj lige duhet të konsultohen me bordin e FAK dhe në bashkëpunim me komisionin përkatës të garave të FAK të caktojnë kohën e mbajtjes së garës.
- 1.5 Në rast se nuk ka interesim nga klubet për organizim të garave në kuadër të Ligës Ekipore, atëhere bordi i FAK merr për obligim organizimin e katër (4) garave në kuadër të kësaj lige!

Neni 2

Kushtet minimale për organizim të garës

- 2.1 Organizatori i garës në mënyrë që të autorizohet nga bordi i FAK për organizim të garës në kuadër të kësaj lige, duhet garën ta organizoj sipas rregullave të FAI (Section 7, FAI Sporting Code) dhe t'i plotësoj kriteret minimale si më poshtë:

- Të sigurohet transporti
- Të sigurohen gjyqtarët
- Të sigurohen pajisjet e nevojshme teknike
- Të sigurohet paketa e drekës dhe uji për pilotë
- Të sigurohen medaljet për 3 vendet e para për meshkujt dhe femrat



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 3

Rregullat e garimit dhe përbërja e ekipit

- 3.1 Të gjithë pilotët duke i përfshirë edhe pilotët që nuk posedojnë licensë nga AAC, që janë anëtar të klubeve aktive të FAK mund të marrin pjesë në garat e ligës ekipore të Kosovës. Pilotët të cilët janë në proces të trajnimit dhe licansimit mund të marrin pjesë në garë vetëm me aprovim paraprak të instruktorit dhe me kusht që gjatë garës janë në monitorim të instruktorit.
- 3.2 Nuk ka kufizim në numër të pilotëve të një klubi që mund të marrin pjesë në secilën garë të ligës ekipore, miërpo kalkulimi i pikëve të fituara për klubin përbëhet nga shuma totale e pikëve të katër (4) pilotëve me rezultat më të mirë nga klubi (metodë e ngajshme me mënyrën e kalkulimit të pikëve shtetërore nga ana e FAI).
- 3.3 Pikët e fituara në këto gara shërbejnë për renditje të ekipeve gjegjësisht të klubeve të FAK, tabela e rezultateve të ligës ekipore të Kosovës paraqet listën e fituesëve sipas Klubeve dhe janë klubet që renditen në vendin 1, 2, 3 e me radhë.

Neni 4

Përkrahja financiare nga FAK për organizator-in/ët

- 4.1 FAK duke u bazuar në mundësitë e saja financiare zotohet ose jo për përkrahje të garave të cilët janë pjesë e ligës ekipore dhe organizimin e të cilave ia ka deleguar një ose më shumë klubi/eve.
- 4.2 FAK obligohet të bëjë pagesën e referëve të secilës garë të ligës ekipore të Kosovës.
- 4.3 FAK obligohet që në faqen e sajë elektronike të prezanton të gjitha informatat për garën.
- 4.4 Të gjitha obligimet tjera financiare për organizim të garës janë obligim i organizatorit/organizatorëve të garës.
- 4.5 Shuma e kuotizimit për pjesëmarrje në garë përcaktohet nga organizatori dhe i njejtë duhet të aprovohet nga bordi i FAK. Shuma e mbledhur nga kuotizimet i takon organizatorit të garës dhe të njejtën duhet ta përdorë për organizim të garës.

Neni 5.

Hyrja në fuqi

- 5.1 Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.
- 5.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 04.03.2019

Artan Venhari, Kryetar i bordit të FAK